



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR I SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Nr. 2843 Prot.

Tiranë, më 16.05.2022

TERMAT E REFERENCËS
PËR "APLIKIM PËR EKSPERT TË KOMSIONIT TË VLERËSIMIT NGA
EKOSISTEMI I STARTUP-EVE"

Në zbatim të ligjit nr. 25/2022 "Për mbështetjen dhe zhvelimin e startup-eve" dhe vendimit Nr. 313, datë 11/05/2022 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij", Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes shpall thirrjen për aplikim për ekspert të Komisionit të Vlerësimit nga ekosistemi i startup-eve.

Qëllimi:

Pjesëmarrja në Komisionin e Vlerësimit të Granteve për shqyrtimin e aplikimeve, vlerësimin e tyre dhe përzgjedhjen si dhe trajtimin e ankesave, rasteve problematike dhe përcaktimin e grantit.

Dokumentacioni në aplikim:

Aplikantët duhet të dorëzojnë me email në adresën: info@sipermarrja.gov.al:

1. Jetëshkrim në gjuhën shqipe ku të përfshihen të dhënat e arsimimit dhe të gjitha eksperiencat e lidhura me fushën.
3. Formular vetëdeklarimi për autenticitetin e të dhënave sipas formatit bashkëlidhur.

Në rast përzgjedhjeje kandidati duhet të sjellë fizikisht pranë Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes:

1. Kopje të dokumentit të identifikimit
2. Kopje të diplomës
3. Dëshmi penaliteti

Kriteret e aplikimit:

Eksperti i ekosistemit të startup-eve, duhet të plotësojë përveç kushteve të përgjithshme edhe kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë diplomë universitare Master në një nga fushat që lidhen me bizneset.
2. Përparësi kanë aplikantët të cilët zotërojnë grada apo tituj shkencorë.
3. Të kenë përvojë në veprimtari dhe fusha që lidhen me mbështetjen dhe zhvillimin bizneseve/ Startup-eve/ inovacionit/ pjesëmarrjen në projekte/ menaxhimin e bizneseve/ trajnime/ mësimdhënie në fusha që lidhen me biznesin.

Afati i aplikimit:

1. Aplikimet do të fillojnë nga data 16/05/2022 dhe do të jenë të hapura deri në datën 26/05/2022.
2. Çdo aplikim i bërë pas këtij afati, nuk do të merret në konsideratë.

Periodha e zbatimit të detyrave:

Periodha e angazhimit të ekspertit do të përcaktohet në kontratë.

Mandati i ekspertit është i vlefshëm për periudhën e disbursimit të grantit Maj-Dhjetor 2022.

Informacion shtesë:

1. Aplikanti fitues nuk mund të aplikojë si përfitues për grantet që do të shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit.
2. Eksperti i përzgjedhur do të paguhet sipas pikës 14 dhe 15 të VKM-së Nr.313, dt.11/05/2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe kriteret, procedurën e përzgjedhjes dhe shpërbërimit të anëtarëve të tij”.

MINISTËR

Edona Bilali

Edona Bilali

